

C.nr.934/13

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, departamenti i pergjithshem-divizioni civil, gjyqtari Enes Mehmeti me procesmbajtësen Minire Krasniqi, ne ceshtjen juridike te inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga Ferizaj kunder te paditures [REDACTED] [REDACTED] te cilen e perfaqeson [REDACTED], me autorizim, per kompesnim te te ardhurave personale, ne seancen e mbajtur ne pranine e paleve ndergjyqjese, me date 16.11.2015 a me date 01.12.2015, ka marr dhe publikuar kete:

AKT GJYKIM

REFUZOHET, në tërësi si e pabazuar, kërkesëpdia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET paditura [REDACTED] që t'ia kompensoj pagën në shumë prej 420.00€, për muajin tetor të vitit 2012, se bashku me interesin dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Secila palë do të bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

Arsy etimi

Paditësi, në padi dhe parashtimet e bëra në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, ka pretenduar se e paditura nuk i ka kompensuar pagën për muajin Tetor të vitit 2012 dhe se këtë pagë në fakt ia ka paguar pas kalimit të periudhës 10 muajshe gjegjësisht në muajin tetor të vitit 2013.

Ka pretenduar gjithashtu se për shkak të vonësës së pagesës së pages objekti kontesti, atij i ajen shaktuar vështirësi dhe shpenzime, për shkak se ka patur kredi në abnke dhe për shkak të vonësës ka paguar interes shtesë tek banka.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura, përmes përfaqësuesit të saj, ka kundërshtuar sit e pabazë kërkesëpdinë e paditësit, duke shtuar se paditësit nuk i është bërë pagesa e pages për muajin tetor të vitit 2012 e cila page i është paguar paditësit dhe përveq pagesës së pages për muajin tetor 2012, paditësit ia janë paguar edhe pushimi vjetor dhe 15 ditë pune me teper për muajin Maj 2013.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-se, ka bërë administrimin e provave si vijojnë: pasqyra e pagesave për muajin tetor 2012, kontrata e punës e paditësit për vitin 2009, pasqyra e pagesave për muajin shtator 2012, muajin Maj, Qershor dhe Korrik të vitit 2013.

Gjykata pasi ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e provave të çështjes, në kuptim të nenit 8.1 të LPK-se, kur mbi bazën e cmuarjen së lire dhe me ndergjegje të tyre, secilen vec e vec dhe si tërësi, ka gjetur se duhej vendosur si në dipozitiv, për keto arsye:



Nuk ishte kontestuese ne mes paleve se e paditura paditesit, pagen per muain tetor te vitit 2012 ia ka paguar me vone prej 10 mujash gjegjesisht ia ka paguar ne muajin Korrik te vitit 2013. Fakti i tille meqe eshte I pakontestueshem nga ndergjygesit, gjykata e ka pranuar si ekzistent.

Kontestuese ne mes paleve ishin pretendimet e ngritura nga paditesi ne seancen e shqyrtimit kryesor, lidhur me kerkesat ne emer te demit te shkaktuar si pasoj e voneses se pageses se pages per muajin Tetor te vitit 2012 nga e paditura. Paditesi ka pretenduar se me kete rast Ai ka pesuar nje dem dhe ka te drejte te kompensohet per kete. Nuk ka precizuar ne seaqnce ndonje shume perkitazi me kete lartesi te demit.

Me parashtresen e dorezuar me date 20.11.2015, paditesi ka pershkruar me doreshkrim lartesine demit ne shume prej 60.00€, pa dorezuar deshmi mbeshtetese relevante per kete pretendim.

Gjykata pretendimet e paditesi per lartesine e demit ne shume prej 60.00€, te parashtuar pas perfundimit te shqyrtimit kryesor te ceshtjes, e ka vleresuar si shkrese e jo ndonje prove qe provon ndonje pretendim per ndonje dem eventual qe paditesi ka pesuar dhe si te tille, gjykata ka vleresuar se perkitazi me cfrado pretendimi te paditesit per ndonje dem eventual. per shkak te mospageses ,me kohe te pages se paditesit per muajin Tetor 2012,nga e paditura jane thjesht pretendime deklarative e jo te mbeshtetura ne ndonje prove, ndaj per aq sa paditesi ka arritur te provoje ekzistimin e pretendimeve te tija, te ngritura ne shqyrtimin kryesor te ceshtjes, gjykata ka cmuar se te njejtat jane te pambeshtetura ne prova.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedures ka vendosur ne baze te nenit 452.2 te LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.934/13 date 01.12.2015

Gjyqtari,

Enes Mehmeti

Keshilla Juridike: Kunder ketij Aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 7 ditesh, pas pranimit te njetit, ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.

